



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 40/2 Prot.

Tiranë, më 11/3/2011

Lënda: Rekomandim për **Euromax Sh.p.k** .

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Euromax Sh.p.k** ,

KONSTATOVA

Më datë 20.12.2010 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, **Euromax Sh.p.k**, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (kategoritë e subjekteve, klientë punonjës etj.).
- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara në nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).

- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

- 1- Kontrolluesi, “EUROMAX” sh.p.k, Tiranë, në formularin e njoftimit për përpunimin e të dhënave, detyrim ligjor në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, nuk ka deklaruar përpunimin e të dhënave personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave “klientë”. Fakti që një klient pajiset me kartë anëtarësie, sipas të cilës grumbullohen të dhëna personale të tij, tregon se, kontrolluesi përpunon të dhëna të kësaj kategorie. Gjithashtu, marketingu i drejtpërdrejtë që realizohet nëpërmjet mesazheve sms, në telefonat celular të klientëve rikonfirmon përpunimin e të dhënave për këtë kategori.

Kontrolluesi nuk ka deklaruar se përpunon kategorinë e të dhënave “adresa”. Rezulton se, në aplikimet për kartë anëtarësie të *klientëve* (aplication form), kërkohet adresa e saktë e aplikantit.

Gjithashtu, nga lista e dokumentave që një *punonjës* duhet të paraqesë për të filluar punë pranë kompanisë “ Euromax “ njëri nga dokumentat e kërkuara është “ vërtetimi për adresën e banimit”.

Kontrolluesi nuk ka deklaruar në rubrikën 4 “ Qëllimi i përpunimit” të Formularit të njoftimit dhe as në shkresën e dytë nr. 327/1, datë 01.06.2010 të dërguar nga kontrolluesi pranë KMDP, përpunimin e të dhënave për qëllim marketingu.

Kontrolluesi nuk ka deklaruar në rubrikën 7.2 “ Përpunohen të dhëna sensitive” nën rubrikën “Gjëndja penale”. Nga lista e dokumentave që një punonjës duhet të paraqesë për të filluar punë pranë kompanisë “ Euromax “ një prej dokumentave të kërkuara është vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata e rrethit.

Sipas nenit 3/7 “ Përpunimi i të dhënave” është cdo veprim që kryhet plotësisht ose jo me mjete automatike, me të dhënat personale, si grumbullimi, regjistrimi, ruajtja, renditja përshtatja, ndreqja, këshillimi, shfrytëzimi, përdorimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi apo çfarëdo veprim tjetër si dhe transmetimi i të dhënave”.

Përsa i përket rubrikës 10 të paplotësuar nga kontrolluesi dhe e padeklaruar edhe në shkresën nr. 327/1, datë 01.06.2010 të dërguar nga kontrolluesi pranë KMDP, nga kontrolli administrativ i ushtruar rezultoi se, kontrolluesi ka rregulla të qarta për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave. Gjithashtu, aksesit është i përcaktuar dhe i kufizuar. Personat që kanë të drejtë të hyjnë në këto të dhëna, janë vetëm ata persona që e kanë të përcaktuar këtë të drejtë në rregulloret e kompanisë dhe përshkrimin e punës (Job

Discription), por në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” është i detyruar të plotësojë rubrikën e sipërcituar në Formularin e Njoftimit

- 2- Kontrolluesi, “EUROMAX” sh.p.k në aktivitetin e tij grumbullon dhe përpunon të dhëna personale të klientëve.

Këto të dhëna grumbulloheshin nga kontrolluesi në formën e një karte anëtarësie dhe që shërbente për të kryer edhe marketing të drejtpërdrejtë dhe në të cilën grumbulloheshin këto të dhëna: Emri, Mbiemri, numri i telefonit celular, datëlindja, gjinia, statusi civil, arsimi, vendbanimi, adresa, tel. familjar dhe Barcode.

Për kategorinë “klientë” u konstatua se : për të dhënat që grumbulloheshin nga kontrolluesi në formën e një karte antarësie, e cila shërbente për të kryer edhe marketing të drejtpërdrejtë nuk ishte marrë pëlqimi i klientit cfarë bie ndesh me nenin 3, parag. 12 : **Pëlqimi** “ është deklarata specifike, e dhënë me vullnet të lirë nga subjekti i të dhënave personale për përpunimin e të dhënave të tij “ dhe nenin 6 pika 1”a” ... Të dhënat personale përpunohen vetëm: ...” nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin”, ndërkohë u kontaktua që nga klienti nuk merrej pëlqimi si për përpunimin e të dhënave ashtu edhe për marketingun e drejtpërdrejtë.

Kjo bie ndesh edhe me përcaktimet e nenit 18 te ligjit “...”Kontrolluesi kur mbledh te dhëna personale, duhet ta informojë subjektin e këtyre te dhënave...” pasi klientit nuk i ofrohej mundësia e informimit mbi autorizimin për përpunimin e të dhënave personale, në një rubrikë të vëçantë, të qartë dhe të shprehur për qëllimin e mbledhjes së këtyre të dhënave dhe për dhënien e pëlqimit.

Përveç faktit që, kontrolluesi nuk merrte pëlqimin nga klienti, mbledhja e të dhënave si “Statusi civil “ dhe “Arsimi”, në kartën e aplikimit të klientit, nga grupi i inspektimit u gjykua se ishin të tepërta, kjo sipas nenit 5, gërma ”c”, i cili shprehet: “...të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e kalojnë këtë qëllim”. Kjo për sa i përket identifikimit të klientit.

Për sa i përket realizimit të marketingut të drejtpërdrejtë që, ky kontrollues kryen nëpërmjet sms-ve, klienti duhet të japë pëlqimin që: ai dëshiron të informohet për produktet e hedhura në treg, nga kontrolluesi “EUROMAX” sh.p.k. Të dhënat “Statusi civil “ dhe “Arsimi”, rreth klientit, duhet të përfshihen në rubrikën për realizimin e marketingut të drejtpërdrejtë. Kjo për faktin se është e tepert për të bërë identifikimin e subjektit të të dhënave për aplikim pasi të dhëna si emri, mbiemri, vendbanimi dhe nr i telefonit celular janë të mjaftueshme për anëtarësim, cdo e dhëne tjetër është e tepert në kuptim të nenit të sipërcituar, pra del jashtë qëllimit për të cilin mblidhen këto të dhëna.

Deklarata dhe dhënia e autorizimit duhet të jetë e ndarë dhe e veçantë për të dyja kategoritë e mësipërme, ku subjekti i të dhënave personale (klientët) duhet paraprakisht

të informohen, në mënyrë të shkruar se, për çfarë konkretisht është duke dhënë pëlqimin, gjithashtu, formula e dhënies së pëlqimit duhet të jetë e ndarë në: dhënien e pëlqimit nëpërmjet nënshkrimit të klientit, për përpunimin e të dhënave, si dhe formular i veçantë për dërgimin e materialeve informuese, publicitare ose promovionale. Tek kjo e fundit, ritheksojmë se, të dhënat e tilla si “Statusi civil” dhe “Arsimi” të përfrshihen në formularin e dhënies së pëlqimit për marketingun e drejtpërdrejtë, dhe të mos përfrshihen te pjesa e Kartës së klientit (aplication form).

Ndarja në dy rubrika të veçanta, do i mundësojë subjektit të të dhënave (klientit), se në çfarë procesi të iniciuar nga Kontrolluesi “Euromax”, ai dëshiron të përfrshihet; në atë të anëtarësimit, sipas kartës që i jepet klientit, apo në atë të marketingut të drejtpërdrejtë, apo në të dyja bashkë.

- 3- Përsa i përket tabelave paralajmëruese në zbatim të nenit 18 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” u konstatua se, ambientet e brendshme, ku tregtohen produktet e kompanisë “Euromax”, pranë QTU-së nuk ishin të pajisura me tabelat paralajmëruese, të cilat janë të detyrueshme, të vihen në vende të dukshme.
- 4- Nga grupi i inspektimit u konstatua që, ambientet e kontrolluesit ishin të pajisura me sistem kamera veëhgimi. Pas verifikimeve dhe diskutimeve me kontrolluesin u konstatua se, kontrolluesi kishte lidhur një kontratë me kompaninë “Pelikan Security” sh.p.k e cila ishte përgjegjëse për sistemin e video-survejjimit dhe njëkohësisht në rolin e përpunuesit sipas përkufizimit të nenit 3/5 të ligjit “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”, punonjësi i së cilës kishte vetem akses vizual dhe jo material.

Për aksesin vizual të këtij punonjësi nuk kishte një akt që ta ligjëronte këtë akses , kjo sipas përcaktimeve të nenit 27/2, germa”ç”, Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

“ ...Ndalon hyrjen në mjediset e kontrolluesit ose përpunuesit të të dhënave të personave të paautorizuar “.

Sic u sqarua më sipër, autorizimi ishte vetëm verbal dhe grupit të inspektimit nuk iu vu në dispozicion ndonë dokument ligjor ku kjo e drejtë e punonjësit të “ Pelican Secutity “ sh.p.k të ishte e përcaktuar. Kjo e drejtë aksesit nuk rezulton as nga kontrata e sipërmarrjes e lidhur midis kontrolluesit dhe “ Pelican Secutity “sh.p.k me objekt., “ Për ruajtje objekti nëpërmjet qëndrës përgjuese të sistemeve të alarmit”. Nga grupi i inspektimit u kontaktua edhe me përfaqësuesin e kompanisë “Pelikan” për Euromax dhe u bën verifikimet në ambientet ku realizohej regjistrimi.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të Nenit 21, 22 dhe 23 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “EUROMAX” sh.p.k Tiranë duhet të riformuloj Formularin e njoftimit duke plotësuar të gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i inspektimit dhe të bëra të ditura kontrolluesit nëpërmjet procesverbalit dhe pjesës arsyetuese të këtij rekomandimi.
Mosplotësimi në mënyrë jo korrekte dhe të përsëritur i Formularit të Njoftimit, përbën shkelje të nenit 30, pika 2, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit ” *Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave*”.
2. Në zbatim të nenit 3, parag. 12, nenin 6 pika 1, shkronja “ a” dhe nenin 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, kontrolluesi “EUROMAX” sh.p.k Tiranë, i cili përpunon të dhëna personale të klientëve dhe realizon marketing të drejtpërdrejtë nëpërmjet mesazheve (sms) në telefonat celular të tyre, duhet të sigurojë deklaratën specifike për dhënien e pëlqimit nga ana e këtyre personave për :
 - a) përpunimin e të dhënave personale;
 - b) marrjen e mesazheve(sms), për realizimin e marketingut direkt.

Deklarata dhe dhënia e pëlqimit duhet të jetë e ndarë dhe e vecantë për të dyja kategoritë e mësipërme, ku subjektet e të dhënave personale (klientët) duhet paraprakisht të informohen, në mënyrë të shkruar se, për çfarë konkretisht është duke dhënë pëlqimin, gjithashtu Formula e dhënies së pëlqimit duhet të jetë e ndarë në dhënien e pëlqimit nëpërmjet nënshkrimit klientit, për përpunimin e të dhënave dhe për dërgimin e materialeve informuese, publicitare ose promocionale. Të gjitha këto duhet të jenë të parashikuara në Kartën e anëtarësisë (Application form) e cila i jepet klientit nga kontrolluesi. Tek kjo e fundit, theksojmë sërish që të dhënat e tilla si “Statusi civil “ dhe “Arsimi” të përfrshihen në formularin e dhënies së pëlqimit për marketingun e drejtpërdrejtë, dhe të mos përfshihen te pjesa e Kartës së klientit (aplication form). Kjo do i mundësojë subjektit të të dhënave (klientit) se në çfarë procesi të iniciuar nga Kontrolluesi “Euromax”, ai dëshiron të përfshihet; në atë të anëtarësisimit, sipas kartës që i jepet klientit, apo në atë të marketingut të drejtpërdrejtë, apo në të dyja bashkë.

3. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, kontrolluesi “EUROMAX” sh.p.k Tiranë të vendosë tabela

paralajmëruese për vëzhgimin me kamera të të gjitha ambientve të brendshme, të kontrolluesit, të cilat janë të pajisura me sistemin survejues.

4. Në zbatim të nenit nenit 27/2, germa”ç”, kontrolluesi “EUROMAX” sh.p.k Tiranë duhet të përcaktojë në një dokument ligjor, ose në kontratën sipërmarrëse lidhur me shoqërinë e ruajtjes dhe të sigurisë fizike “ Pelican Security “ sh.p.k të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me aksesin dhe personat e autorizuar në të dhënat personale që përpunohen nëpërmjet sistemit të video survejimit.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Në rast moszbatimi të këtyre rekomandimeve, Komisioneri verpon sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

